



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 92/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterve në shtylla të ndriçimit publik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 27.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, dega në Skenderaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.09.2019, nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me të cilën pretendon se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur parregullsi të cilën e kanë evidentuar duke i bashkëngjitur si dëshmi fotografitë e printuara nga vendi i ngjarjes. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 25.09.2019, në Rrugën Sala dhe Hamit Jashari, ish rruga Dëshmoret e Kombit në Skenderaj, në afërsi të sheshit kryesor të qytetit Adem Jashari, monitoruesi i tyre ka hasur në postera të kandidatit për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga subjekti politik PDK, të ngjitur në hapësira publike dhe atë në trafo të energjisë elektrike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33, paragrafi 1 pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Ligji Nr.03/L-073, në momentin që subjekti politik PDK, ka vendosur poster të kandidatëve për deputet në hapësira publike.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkëngjitur një foto të printuar.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Kosovës PDK, të datës 27.09.2019, thekson se këto veprime nuk janë në kundërshtim me LZP-në, ndërsa vendosja e posterit është në objekt privat të kompanisë në fjale me të cilën kompania ka marrëveshje me kandidatin. Në përgjigjen e saj PDK, thekson se ka ndërmarr veprime duke e evituar shkeljen dhe duke e larguar posterin nga vendi ku ka qene i vendosur ai, për të cilën ka bashkëngjitur dëshmitë (foto) si pjese të përgjigjes.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruara si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se posteri i kandidatit për deputet, nga radhët e subjektit politik PDK, është i vendosur në trafo të rrymës elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së, e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti se posterët e kandidatëve nga ky subjekt janë vendosur në trafo elektrike, pra në vende apo hapësira publike. Po ashtu si rrethanë PZAP-i, e mori edhe faktin që subjekti politik në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 92/2017 më datën 27.09.2019.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 1 të LZP-së.